



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ROSKOVEC

Adresa: Lagjia Nr.1 Qender, Tel : + (355) 038780241, Email : info@bashkiaroskovec.gov.al

PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE 04 NENTOR 2022 NE FSHATIN KURJAN

Vendi : Fshati Kurjan, prane Kishes Shen Koll.

Ora : 11:00

Tema e Konsultimit : Prezantim dhe diskutim per projekt – idene e ndertimit te “**Pikes se Grumbullimit te Ullirit**”

Baza Ligjore : Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në nenin 9 pika 1.3, nenin 27 , të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Pjesëmarrës : Kryetarja e Bashkisë znj.Majlinda Bufi, Nenkryetari i Bashkisë Z.Maksim Goga, Nenkryetari i Bashkisë Z. Klodjan Lushka, Sekretarja e Keshillit znj.Arlinda Hajdini, Drejtore e Sherbimeve Sociale znj. Enerjeta Shehu, Prefekti i Qarkut Fier Z. Lefter Shehaj, Deputete e Qarkut Fier Znj. Mirela Pitushi , Drejtori Ekzekutiv INFOCIP, Z. Gerti Shella, Krye-Koordinatori / STAR 3 , Z.Artur Kurti, Perfaquesues nga Qendra ABA, Perfaquesues te larte te organeve qendrore ne nivel vendor, te pranishem rreth 50 banore te zones.

Takimi u hap nga Kryetarja e Bashkise znj. Majlinda Bufi e cila falenderoi te gjithe pjesemarresit per prezencen e tyre, duke ftuar per te bashke-drejtuar kete takim Drejtorin Ekzekutiv/ INFOCIP Z. Gerti Shella.

Z. Gerti Shella : Me ftese te Kryetares se Bashkise znj. Majlinda jemi sot ketu bashke me koleget e UNDP per te ndare me ju pervec gezimit te kesaj dite edhe nje model te degjeses publike dhe te konsultimit qe po implementohet nga UNDP ne shtate bashki te cilat permbushin disa tipologji te vecanta. Bashkia Patos dhe bashkia Roskovec kane potencialin e shkelqyer per

te modeluar te gjithe praktiken e konsultimit publik ne te gjitha bashkite e vendit dhe ne jemi shume te kenaqur sot qe edhe ne kornizen e kesaj feste te mrekullueshme me energji te jashtezakonshme te perfitorjme nga rasti te ndajme me njeri-tjetrin pervec prezantimit te projektit per piken e grumbullimit te ullirit edhe ato qe mund te jene kerkesa direkte te prodhuesve dhe kultivuesve te ullirit. Une jam shume i kenaqur qe sot ketu ndodhet ne nivel drejtues kryetari i grupit te parties socialiste z. Taulant Balla, Prefekti i Qarkut Fier z. Lefter Shehaj. Me energjine qe ju karakterizon ne te mundemi bashkarisht t'i komunikojme problemet qe ju hasni ne kultivimin, ne prodhimin e ullirit, pse jo edhe ne menyre sesi duhet te jete nje pike grumbullimi model per ullirin, ne menyre qe ne te kemi mundesi ta dokumentojme drejt dhe t'i shtojme te gjitha bashkite e tjera per ceshtje te ngjashme por edhe per ti dhene realisht nje dimension ligjor atyre qe perbejne nje nder bloqet apo themelet e demokracise ne nivel vendor qe eshte permasa e konsultimit publik.

Kryetarja e Bashkise : Nga vet fakti qe e kam me shume deshire kete inisative po zgjedh qe edhe ta prezantoj vete drejtperdrejt me ju. Para se te nis prezantimin dua te ndalem shkurtimisht tek rendesia e degjesave publike. Degjesa publike per cdo lloj tematike eshte detyrim ligjor por me teper sesa aq eshte edhe detyrim moral. Ne lidhje me tematiken e degjeses se sotme ka te beje me grumbullimin e vajit te ullirit. Qe ne momentet e para qe une kam ardhur ne detyre duke pare faktin qe Roskoveci ka nje siperfaqe 70% fushe dhe 30% koder, bima e ullit ishte dhe eshte bima baze e zones kodrinore , e gjithve familjeve qe jetojne ne njesine e Kurjanit, e zones se Strum dhe Vermish dhe sipas nje inventari qe ne i beme bimes se ullirit para kater viteve na kane rezultuar 450 mije rrrenje ulliri te vjeter dhe te rinj ne te gjithe pjesen kodrinore te Roskovecit. Po ashtu duke pare edhe kerkesen e shtuar te vajit te ullirit, kultivuesit kane filluar ta shtojne siperfaqen e mbjelljes se bimes te ullirit. Ne kete menyre vjen nje moment dhe tregu “ngopet”. Vitin e kaluar ne u perpoqen edhe me ministrine e bujqesise qe te fillonim te testonim sesa vaj mund te eksportonim dhe problemi qe na doli ishte se vaji i ullrit perpunohet pa u ndare sipas llojeve te vet dhe per pasoje ne fund del nje produkt qe ne te vertete nuk e dime se cfare realisht eshte. Ky produkt duhet te dale i ndare. Vetem ne momentin qe t'i e ke ndare vajin e ullirit sipas llojit te vet atehere eshte plotesuar kriteri i pare qe t'i mund ta shesesh si ne tregun vendas dhe ne ate jashte. Duke studiuar situaten arritem ne nje moment qe mbasse mos duhet te kemi ketu ne Roskovec nje pike grumbullimi per vajin e ullirit. Menyra per te realizuar kete gje eshte kur bashkia behet si pjese e aplikimeve, si shoqeri aksionare me kritere sipas ligjit. Ne e kemi filluar

tashme kete procedure dhe ne mbledhjen e ardhshme te keshillit do te miratohet. Ne kete pike na duhet bashkimi i fermereve, i kultivuesve te vajit te ullirit dhe po ashtu i prodhuesve, te tre se bashku do e bejme te mundur, se bashku dhe me dokumentacionin perkates per ta mbyllur kete procedure. Ajo qe duam te arrijme sot eshte mirekuptimi i te gjithve per ta cuar me tej nismen. Pres kerkesa, sugjerime, dhe idete tuaja .

Z.Gerti Shella : Kryetare ju e shprehet shume qarte, ne para disa ditesh ishim ne bashkine Patos ku edhe aty kishte nje feste per ullirin dhe kuptuam qe problem nuk ishte prodhimi, madje ka mbiprodhim, as perpunimi i ullirit nuk ishte problem, por ajo qe konstatuam ishte gjetja e tregut, apo edhe kontraktimi mund te kene nevoje per tu pare me kujdes ku bashkia, pushteti vendor, brenda funksioneve qe ligji i percakton sa i takon edhe ceshtjeve te buqesise dhe te prodhimit mund te beje nje pune shume te madhe. Ne kemi shume besim qe kjo tematike e re e ketyre degjesave do te rezonoje edhe me interesin e perpunuesve apo prodhuesve te vajit te ullirit. Une do doja te ftoja dike per te kuptuar nese rezonon e njejtta ide edhe me fermeret.

Z.Nebi Caushi: Pershendetje, Prodhim ka por kemi problem me shitjen. Te na krijohen mundesite nga bashkia per ngritjen e nje pike grumbullimi.



Kryetarja : Ju e prodhoni vajin e ullirit te ndare apo bashke ?

Z. Nebi Caushi : Po, Une e prodhoj vajin e ullrit te ndare ne tre ose kater varitete te ndryshme.

Z. Gerti Shella : Ne Tirane sa mundeni qe te shisni ne markete, ku eshte gjysma e tregut vendas?

Z.Nebi Caushi: Une aktualisht kam certefikate dhe mund te shes ne supermarket por nuk preferoj te bashkepunoj , kam krjiuar pikat e mijas te shitjes.

Z. Gerti Shella : Nese un shkoj sot ne marketet e Tiranes ku une jetoj, raftet ne 70% te gjithave marketeve kane shume me teper prodhim Italian dhe shume me pak sasi te vajit vendas. Ndersa

kur dalim ne terren shohim qe prodhimi vendas eshte ne sasi te medha. Une dua te ndihmoj procesin sesi bashkia ne permbushje te funskioneve te saj ne bashkepunim me fermeret te dominojne tregun vendas.

Z. Nebi Caushi: Une jam i bindur qe vaji qe ne prodhojme eshte shume here me i mire se vaji qe prodhohet jashte por ne nuk kemi mundesi shitjeje.

Znj. Ornela Gjika/ Qendra ABA : Doja te sqaroja pse kemi ardhur sot ketu, une punoj prane Qendres ABA, e cila i jep asistence teknike sektorit te bujqesise dhe blegtorise. Ajo qe mund te prezantoj ketu eshte se ne kemi nje eksperince bashkepunimi ne Roskovec me Z. Flamur Kocaqi anetar i grupit themelues te GVV-se ne Roskovec, dhe mund te ndihmojme kete process per te ecur perpara.

Profesor Shpend : Kam vite qe kam punuar ne kete zone. Doja te thoja qe sasia e prodhimit te vajit te ullirit eshte madhe dhe ajo cka duhet te synojme ne eshte qe ta shesim pertej kufirit. Per ta bere te mundur kete gje une do jap 3-4 sugjerime qe mendoj se jane te vlefshme:

- 1. Di qe vetem dy lloje varietete kemi ketu Kalinjot dhe Frontoji dhe hapi i pare eshte te shtojme sasi ne funskion te ketyre dy kultivanteve pa u zgjeruar me teper.**
- 2. Sugjeroj qe distance e mbjelljes se bimeve te ullirit te jete ne nje largesi te caktuar, jo shume afer bima nga bima.**
- 3. Mendoj se duhet te krijojme mundesine e mbjelljes ne koder dhe jo ne fushe, pasi prodhimi ne koder eshte me i mire.**

Keto jane elementet bazale qe une sugjeroj dhe jam i gatshem per cdo lloj bashkepunimi.



Fermer Flamur Kocaqi: Pershendetje, Se pari une mendoj qe ne duhet te degjojme sugjerimet dhe mendimet e eksperteve, pa mendimet e tyre nuk mund te arrrijme te bejme gjerat ne menyren e duhur. Ne ditet e sotme ajo cka me shqeteson me teper eshte se ne nuk gjejme dot dhe

agronome te mire. Mbeshtes shume mendimin e profesorit dhe nga qendra ABA do te keni mbeshtetje.



Z.Gerti Shella : Duke falenderuar te gjithe dhe duke garantuar besueshmerine e dokumentitmit te plete te takimit mbyll fjalen e tij.



Kryetarja mbyll takimin duke falenderuar te gjithe pjesemarresit dhe duke shpresuar qe gjithcka do te finalizohet me sukses.


FOTO – GALERIA E TAKIMIT





LIST – PREZENCA

LISTE PREZENCE							
Nr.	Emer Mbiemer	Moshë	F/M	Institucioni	E-mail	Nr.Telofoni	Firma
1.	Gertime Joxha	30	F	—	—	0697859151	
2.	Suzureta Mësuesa	41	F	—	—	—	
3.	Shena Tafaj	76	F	—	—	—	
4.	Hastija Çanta	74	F	—	—	—	
5.	Ajenditaj Gëpoli	52	F	—	—	—	
6.	Alpresaleti	—	—	—	—	—	
7.	Hysen Pashali	60	M	—	—	—	
8.	Sadrija Lekaj	—	—	—	—	—	
9.	Anxhelita Tarolca	18	F	—	—	0692560428	
10.	Nedzi Gashi	—	M	—	—	0693405591	
11.	Bajraç Gashi	50	M	—	—	—	
12.	Zelma Tashku	37	M	Newbridge	zelma.tashku@gmail.com	069353765	
13.	Hysen Pashali	60	M	—	—	—	
14.	Shpend Shabani	—	—	Alpresaleti	—	—	
15.	Agimra Sopi	50	F	2VA Polloga hysenpashali@gmail.com	—	—	
16.	Jelalat Venca	52	M	D SH. Peffice Vilagraga	0697870916	0693405591	
17.	Qelal Mësuesa	30	M	NSH Tugor	0693777882	0693627777	
18.	Kadrijaq Bushka	—	—	—	—	—	
19.	Hamza Pasha	—	—	—	—	06925622429	
20.	Bajram Kukeli	—	—	—	—	0683628616	
21.	Editha Doko	—	—	DPAKPAPIR edithadoko@gmail.com	0694233011	0693405591	
22.	Almude Haxha	36	F	Set. Fashilli	0693018560	0693405591	
23.	Envera Shala	29	F	Im. Shala e ciklopediqe	0693240603	0693405591	
24.	Teksi Gora	54	M	RESHILTAKE	0697366478	0693405591	
25.	Levanard Haxha	54	M	Nalidetra	06926144687	0693405591	
26.	Armenka Bushka	34	F	Digital Banka	0693587993	0693405591	
27.	Ivana Kuqo	—	—	Hesueso	0699131486	0693405591	
28.	Memona Xhemali	35	F	Mesuere	0697622253	0693405591	
29.	Camira Buzi	50	F	Mesuere	camirabuzi@gmail.com+49	0693405591	
30.	Hilzeta Ramonka	—	—	—	—	—	
31.	Merlenka Bata	—	—	—	—	—	
32.	Elvida Kylo	—	—	—	—	—	

Emer Mbiemer	Moshë	Egjipti	Institucioni / Profesioni	dimërdhës	E-mail.com	
33. Arjanë Dima	98	F	Mësuese	—	0693661016	
34. Lumturi Mësuesa	46	F	Mësuese	Lumturi.mesa@gmail.com	0692294829	
35. ORNETA GJELA	50	F	By.Uteri	—	06982086312	
36. Drine de Fezallë	44	F	Pj. Ujeziste	drine.defezalle@gmail.com	06922097602	
37. Don-Bin S-Aripa	48	M	CATHOLIC	—	06936097602	
38. Hyza	60	M	Etëpërmist	—	069618514	
39. Aleti Sajo	30	M	Specialist	—	0694582593	
40. Beni Isidor	24	M	Specialist	—	0685552392	
41. Cakë Shena	25	F	Specialiste	—	0670047658	
42. Miriamë Gjelë	51	F	Dijital/Post/Office	—	0693916466	
43. Harrilla Cajo	62	M	Qytetar	—	0695560902	
44.	—	—	—	—	—	
45.	—	—	—	—	—	
46.	—	—	—	—	—	
47.	—	—	—	—	—	
48.	—	—	—	—	—	
49.	—	—	—	—	—	
50.	—	—	—	—	—	

Enerida Kuqo



Koordinator per Njoftimin dhe

Konsultimin Publik

Arlinda Hajdini

Sekretare e

Keshillit Bashkiak

